

VENDIM
Nr.251, datë 27.4.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 17.12.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR
DHE PËR KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE, PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i fundit i pikës 4.2.1. ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky titull mund t’u jepet, pa respektuar afatet e mësipërme kohore, kandidatëve, që kanë mbaruar studimet, universitare dhe pasuniversitare (doktoraturë), me rezultate të larta (notë mbi 9), kur ata plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë botuar, si autorë të parë, së paku pesë artikuj shkencorë origjinalë në gjuhë të huaj. Tri prej tyre duhet të jenë botuar në revista shkencore, me bord editorial, dhe një artikull të jetë i botuar në një revistë, me faktor impakti;

- Të kenë bërë, si autorë të parë, së paku pesë referime ose prezantime në kongrese ose konferenca shkencore ndërkombëtare, të botuara në “proceedings” me numër ISSN-je;

- Të kenë botuar, në gjuhë të huaja, një monografi, të ndryshme nga disertacioni i doktoratës ose masterit, e cila zëvendëson tre artikuj shkencorë origjinalë dhe dy referime në kongrese/konferenca ndërkombëtare;

- Të kenë botuar në gjuhën shqipe dy monografi, të ndryshme nga disertacioni i doktoratës ose masterit, të cilat zëvendësojnë tre artikuj shkencorë origjinalë dhe dy referime në kongrese/konferenca ndërkombëtare;

- Të kenë dhënë mësim (leksione e seminare) në shkollën e lartë, së paku për pesë vite akademike;

- Të kenë bërë punë kërkimore, të kenë dhënë mësim në një shkollë të lartë a qendër kërkimore — mësimore, perëndimore, së paku për një vit akademik, dhe të kenë fituar në një universitet të huaj një status të ngjashëm me atë të profesorit të asociuar;

- Të jenë titullarë, së paku në një lëndë;

- Të kenë dhënë kontribut në zhvillimin akademik të shkollës së lartë;

- Të jenë në gjendje të japin mësim në një gjuhë të huaj, perëndimore.”.

b) Paragrafi i fundit i pikës 4.2.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky titull mund t’u jepet, pa respektuar afatet e mësipërme kohore, kandidatëve, që kanë mbaruar studimet, universitare dhe pasuniversitare (doktoraturë), me rezultate të larta (notë mbi 9), kur ata plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë botuar, si autorë të parë, së paku tre artikuj shkencorë origjinalë, në gjuhë të huaj, prej të cilëve, së paku, dy në revista shkencore ndërkombëtare, me bord editorial;

- Të kenë bërë, si autorë të parë, së paku tri referime ose prezantime, në kongrese ose konferenca shkencore, ndërkombëtare, të botuara në “proceedings” me numër ISSN-je;

- Të kenë zhvilluar veprimtari, kërkimore ose mësimore, në një universitet a qendër kërkimore, të njohur, ndërkombëtare, për së paku një vit akademik;

- Të kenë dhënë mësim (leksione e seminare), së paku për dy vite akademike, pas përfundimit të doktoratës;

- Të jenë në gjendje të japin mësim në një gjuhë të huaj, perëndimore.”.

2. Pezullimin e procesit të dhënies së gradave dhe të titujve për punonjësit e institucioneve kërkimore, në varësi të një dikasteri ose të Akademisë së Shkencave, deri në përfundimin e organizimit të këtyre institucioneve dhe në përcaktimin e rregullave të reja për to.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha